

Kategoria Superiore/ Kukesi – Vllaznia 1-3

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Shtator 2013 17:00



Surpriza e madhe e javes eshte humbja e Kukesit ne shtepi dhe fitorja e kuqeblove ne nje fushe mjaft te veshtire. Skuadra e Armando Cungut duket se ka mbetur me pasoja nga suktesi ne Europe dhe tani po has veshtiresi per te kuptuar realitetin e futbollit ne vend. Tre gola te shenuar nga Vllaznia dhe vetem nje nga skuadra veriore qe ne javen e dyte merr humbjen e dyte duke komplikuar shume objektivin per te fituar titullin kampion. Gjithcka eshte vendosur ne pjesen e dyte kur jane shenuar edhe te katert golat. Fillimisht Vllaznia ka zhblokuar rezultatin me ane te Basic dhe me pas kane barazuar lojtaret e Kukesit me ane te Prognit. Kukesi eshte hedhur i gjithi ne sulm per te shenuar golin e fitores por hapesirat qe jane lene pas jane shfrytezuar nga lojtaret e Vllaznise qe kane shenuar dy gola me ane te Krujes duke marre tre pike te cmuara ne transferten e veshtire kuksiane.